

n. 813 Pro Y
02.09.2016

FM

266
05.09.2016.



Office in Tirana:
Albania SurPlace Scholarships
Dr. Eda Terezi
c/o DIHA German Association of Industry and Trade in Albania
Rr. Skenderbej 4/7
Tirana
Tel: +355 68 6680070
Email: Terezi@wusgermany.de
Internet: www.surplace-albania.de

Tiranë, më 16/8/2016

Lënda: Mbështetje me bursë 6-mujore për studentët e Universiteteve Shtetërore Shqiptare.

Drejtuar:

Te drejtohet
shpresa në të
3 fakultetet

Z. Mynyr Koni
Rektor i Universitetit të Tiranës

Z. Andrea Maliqari
Rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës

Z. Bahri Musabelliu
Rektor i Universitetit Buqësor të Tiranës

Z. Arben Gjata
Rektor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Z. Adem Bekteshi
Rektor i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër

Z. Bektash Mema
Rektor i Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër

Z. Roland Zisi
Rektor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë

Znj. Keanale Sotirofski
Rektor i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës

Z. Ali Jashari
Rektor i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë

Z. Skënder Topi
Rektor i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Z. Kastriot Caushi ✓
Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë

Të nderuar zotërinj Rektore,

Ju bëj me dije se Universiteti i Landit të Hessenit dëshiron të mbështesë me bursa 6-mujore studentët e universiteteve shtetërore shqiptare me arritjet më të mira akademike, përmes një projekti të çelur rishtas në Tiranë.

Presidenti i Universitetit Z. Kambiz Ghawamí, ka zhvilluar edhe një takim me Ministren e Arsimit në datën 4 Korrik 2016, ku i ka bërë të njohur projektin.

Qëllimi i kësaj mbështetje është forcimi i elitës së arsimuar në Shqipëri dhe nxitja e trajnimit i specialistëve të ardhshëm. Ky universitet do të ofrojë bursa 6-mujore (250 € në muaj) *për studentë në vitin e fundit ose që janë në fazën e hyrjes së tyre në tregun e punës, apo që dëshirojnë të fillojnë një biznes.* (Përfundimet e pritshme në këto tre kategori janë deri në vitin shkollor 2018). Preferohen studentë me të ardhura të ulta familjare. Synimi është që të rinjtë Shqiptarë të mund të zhvillojnë perspektivat e ardhshme profesionale në Shqipëri. Numri i përgjithshëm i studentëve që do të përfitojnë këtë bursë do të jetë 50 gjithësej, nga të cilët 25 do të jenë femra dhe 25 meshkuj.

Gjatë periudhës maksimale të grantit prej gjashtë muajsh, studentët do të marrin trajnim për aplikim për punë dhe trajnim për të filluar një biznes si dhe punë praktike të specializuar (individual dhe në grupe), në varësi të llojit të grantit.

Në faqen e internetit www.surplace-albania.de ku do të gjeni formularin e aplikimit me udhëzimet përkatëse. Ose mund të klikoni gjatë në webin: <http://www.wusgermany.de/en/internationale-bildungsarbeit/wus-international/scholarship-and-training-albanian-students>.

Afati i fundit për raundin e parë është 15 shtator 2016.

Aplikimi do të bëhet pranë zyrës World University Service në Tiranë, adresa e së cilës është publikuar në këtë faqe zyrtare.

Duke shpresuar në një bashkëpunim të frytshëm në të ardhmen.

Dr. Eda Terezi



Project Coordinator
Albania SurPlace Scholarships
c/o DIHA German Association of Industry and Trade in Albania
Rr. Skenderbej 4/7
Tirana
Tel:: +355 68 6680070
Email: albania@wusgermany.de
Internet: www.surplace-albania.de